

FJALA E DEPUTETIT DAMIAN GJIKNURI

E ENJTE 21 KORRIK 2022

Në fakt, nëse ka një element, ku konstatohet progres, është kur një çështje që dikur ishte e madhe, tani kthehet në rutinore. Madje, dikush tha se kjo nuk ka rëndësi, sepse është gjë burokratike. Nuk e kam për ta zhvlerësuar atë që e tha, por të mos harrojmë se problemi që vinte nga KQZ-ja në shumë zgjedhje të kaluara, ka qenë problemi themelor. Fakti që tashmë e quajmë një rutinë burokratike, është një sukses për mbajtjen e zgjedhjeve në Shqipëri dhe është sukses për KQZ-në.

Kjo është e vërteta, pra administrimi i zgjedhjeve është një proces i plotë administrativ, nuk ndikon tek asnjë palë, përkundrazi problemi më i madh në Shqipëri për zgjedhjet ka qenë jo administrimi i tyre, por ajo që quhet kultura demokratike e pranimit të humbjes, shpëtimi i kokës së liderit, kur humbet partia dhe automatikisht shpiket fabula e vjedhjes së zgjedhjeve, e abuzimit me to e të tjera, që, fatkeqësisht, e kanë futur Shqipërinë në cikle krizash të pamerituara, madje duke krijuar shpeshherë edhe kushte të diktuar nga politika e brendshme, sepse kushtet gjithmonë shpiken nga politika e brendshme, nuk vjen ndërkombëtarit të shpikë kushte. Ne shqiptarët ngremë probleme që nuk ekzistojnë, ose probleme që justifikojnë veprimet tona politike, të njërës forcë apo të tjetrës.

Në këtë rast evidente kanë qenë veprimet e vazhdueshme të opozitës për të justifikuar humbjen e saj, që ktheheshin gjoja në kushte. Megjithatë, pavarësisht atyre kushteve, personalisht kam kënaqësinë që kam drejtuar në një proces të vështirë, madje në një klimë të vështirë politike në vitin 2020, një reformë zgjedhore, e cila për herë të parë u shkrua nga A -ja te Zh-ja nga opozita shqiptare. Madje, u investuan miliona euro për të kuruar frikën e opozitës. Ky vend i varfër në kulmin e pandemisë shpenzoi 15-16 milionë euro vetëm e vetëm që të kuronte frikën e një njeriu, i cili kishte frikë të hynte në zgjedhje, që i bojkotoi ato në vitin 2019 vetëm nga frika se nuk donte të ballafaqohej me njerëzit e tij, pasi të dilte rezultati zgjedhor. Kjo është e vërteta.

Më vjen mirë që për përfaqësuesit tuaj (kjo është për t'u përshëndetur, zonja Tabaku u largua dhe nuk e kam për replikë këtë, por për ta vlerësuar) procesi i administrimit zgjedhor nuk pati asnjë problem dhe për herë të parë KQZ-ja nuk ka marrë asnjë akuzë për administrimin e zgjedhjeve. Merita u shkon atyre që e drejtojnë, por, nga ana tjetër, i shkon edhe klimës politike, legjislacionit të krijuar, besimit që i dhanë palët një administrate të pavarur zgjedhore. Ky investim, i bërë me miliona euro, jam i bindur se duhet të na çojë në një hap tjetër të reformës zgjedhore, pasi ne jemi në këtë proces dhe mendoj se ka ardhur koha. Nuk dua që fjalët e mira të merren si diktim i maxhorancës, sepse, në fund të fundit, ajo mbetet gjithmonë një reformë konsensuale dhe kësaj qasje do t'i qëndrojmë deri në fund, por ne mund të adresojmë shumë çështje atje.

Mund të adresojmë çështjen e komisioneve zgjedhore. Nuk kemi pse të kemi përfaqësues politikë. Në zgjedhjet e fundit, në mars, Partia Demokratike nuk gjente komisionerë. Filloi edhe shërri se kujt i përkisnin komisionerët. Pse të mos heqim dorë nga komisionerët politikë dhe të vendosim zyrtarë të zgjedhur me short, ashtu siç u shkrua dhe u ra dakord në vitin 2020, kur bëmë marrëveshjen e 5 qershorit, por fatkeqësisht në minutat e fundit u hoq dorë nga ajo. Pra, ne kemi një model gati, i shkruar nga ekspertë të opozitës. Them se është momenti i mirë që ta miratojmë në Komisionin për Reformën Zgjedhore. Pse të mos heqim dorë nga numërimi i përqendruar? Mendoj se ka ardhur momenti, sidomos tashmë me përfshirjen e elektronikës, me përfshirjen e teknologjisë, të heqim dorë nga numërimi i përqendruar i votës.

Të gjithë jemi dakord që është një torturë e vërtetë. Të gjithë, kur diskutojmë me kolegë të ulur në tavolina jashtë kësaj salle, që ngarkohet me testosterone politike, diskutojmë se cila është zgjidhja më e mirë; pse del rezultati shpejt në Kosovë, në Maqedoni. Jo se ata janë më të zotët se ne, por i numërojnë në qendër votimi. Kaq e thjeshtë është. Pra, po të vendosen zyrtarë, që nuk janë të partive politike, me teknologjinë, që është bërë pjesë e identifikimit të zgjedhësve, gjë që ka qenë një nga problemet që ka ngritur vazhdimisht opozita (dhe hedh poshtë atë, që tha zoti Shehi, nuk mbushen më kutitë), nuk ka më mbushje të kutive, sepse sistemi nuk ta lejon më një gjë të tillë. Sa zgjedhës shkojnë, aq fletë votimi janë. Pra, është zgjidhur edhe ky problem. Nuk ka fare nevojë t'i afrojmë qendrat e votimit, sepse u hodh një ide.

Të kryejmë numërimin e qendrave të votimit dhe rezultati të dalë në kohë. Këtë ne mund ta bëjmë, po të kemi vullnet politik. Ju lutem, nuk dua t'i vrisni këto propozime, se i dëgjoni nga goja im. Këto janë propozime të arsyeshme dhe duhet të merren parasysh. Mendoj se ajo, që ne duhet të bëjmë (në fund të fundit, kemi një hap të mirë të nisur, që e pranojmë për herë të parë, pra kemi një administrim të rregullt zgjedhor) është të heqim dorë nga kontestimi idiot i humbjes, kur humbja është e evidente. Nuk të bën fitues as administrata, as përdorimi i pushtetit dhe as të tjerat, por të bën fitues vota e popullit dhe aftësia jote për t'u përgatitur me kohë përpara zgjedhjeve. Nuk ka fitore që vijnë vetë atje. Ju jeni ata që ngrini akuza, kur humbisni zgjedhjet: "Na i vodhën zgjedhjet". Del fraksioni tjetër i "Foltores" thotë: "Zgjedhjet i humbi Lulzim Basha. Nuk na u vodhën. S'i ka fajet njeri".

Pastaj në momentin që "Foltorja" merr avancë, merr pushtetin brenda Partisë Demokratike: "Unë do ta bëj armik Edi Ramën, se ka vjedhur zgjedhjet". Gjejini një herë me njëri-tjetrin nëse janë vjedhur zgjedhjet apo nuk janë vjedhur. Realiteti është i tillë që zgjedhjet në Shqipëri mund të kenë probleme, si çdo vend tjetër që kalon tranzicionin demokratik, por raporti i ODIHR-it, meqenëse keni qejf ta përmendni, ka një fjali magjike: "Nuk ka pasur prova asnjëherë që një mandat të jetë tjetërsuar apo një forcë të ketë përfituar një mandat për shkak të tërësisë së shkeljeve zgjedhore." Kjo është. Dhjeta nuk është absolute. Unë do ta them këtë: nuk besoj te 100%-shi. Në çdo vend të botës, në çdo shoqëri, në çdo sektor publik, në çdo administrim, në jetën tende, të çdo njeriu ka edhe gabime, ka edhe shkelje të ligjit, patjetër që ka, problemi është: a është gabimi aq i rëndë? A është shkelja e tillë, sa të tjetërsojë rezultatin?

Pra, është pasoja e tillë që të jetë e rëndë që të vërë në dyshim integritetin e zgjedhjeve? Asnjë nuk e ka thënë këtë. Më gjeni një raport që e ka thënë këtë! Përkundrazi, "zgjedhjet kanë bërë progres; zgjedhjet janë përmirësuar." Vetë e thatë këtu se nuk keni pasur gjë me administrimin. Ka probleme për t'u përmirësuar?! Patjetër, shoqëria njerëzore është pronë edhe e gabimeve. Nga ana tjetër, dua të them që le të shërbejmë dhe le ta hapim këtë debat, duke u nisur nga një premisë e mirë për të zgjidhur edhe problemet që kanë mbetur gjatë reformës zgjedhore. Vota e diasporës është diçka që duhet adresuar. Shpresojmë që edhe aty ta gjejë mendjen opozita,

sepse dikush nga ju tha se duhet një zonë e veçantë zgjedhore, dikush tjetër kishte një ide tjetër dhe ai u sulmua si tradhtar.

Unë nuk dua t'i hyj se cili është modeli më i mirë. Ka modele për t'u studiuar, por zgjedhjet ne duhet t'i heqim nga fjalori ynë politik, se problemi i vërtetë i shqiptarëve nuk janë zgjedhjet. Zgjedhjet gjithmonë kanë vajtur atje ku ka dashur shumica e shqiptarëve. Problemi është kultura e pranimit të rezultatit dhe kultura e bashkëpunimit. Unë e kam bindje këtë dhe kështu na mëson historia. Ai që studion histori, nxjerr edhe konkluzione për të ardhmen. Nëse klasa politike shqiptare, nëse palët nuk do të dialogojnë, nuk do të kenë besim te njëra-tjetra, nuk do të ulin gjuhën e tensionit, jo integrimi european që do të jetë i largët, por çdo gjë tjetër do të jetë e largët. Opozita këtu ka një rol të jashtëzakonshëm, sepse, në fund të fundit, është ajo që, kur humb, duhet ta pranojë dhe duhet të ofrojë patjetër bashkëpunimin me maxhorancat.

Maxhoancat janë aty, me vullnetin e shumicës së shqiptarëve; nuk janë aty si pushtues; nuk janë aty për t'i bërë dëme. Mund ta bëjnë punën mirë, mund ta bëjnë keq, keni kritika, hartoni politikat tuaja, por aty është shumicës së shqiptarëve, që përfaqësohen politikisht, me të cilët do të keni gjithmonë detyrimin të bashkëpunoni. Prandaj, le të shërbejë edhe ky moment i mirë. Prandaj, e nisa nga ai moment kur u pranua nga ju ecuria e reformës, ecuria e implementimit të ligjit nga KQZ-ja. Le të shërbejë pikërisht ky produkt konsensual për të thënë mesazhin që, ku ka bashkëpunim për reforma, për të cilat kemi rënë dakord, patjetër që ne e ndërtojmë shtratin për t'i besuar njëri-tjetrit dhe ato 2-3 pika, që i përmenda më lart, mund të jenë model i mirë i bashkëpunimit për zgjedhjet e ardhshme.

Unë, si bashkëdrejtues i Komisionit të Reformës Zgjedhore, do të bëj çmos që të akomodoj çdo kërkesë të arsyeshme të opozitës, gjithmonë me fokus adresimin e rekomandimeve të kahershme të ODIHR-it. Alfa, beta, omega, çfarëdo që t'i thoni, ka qenë dhe mbetet depolitizimi i administratës zgjedhore. Hidheni edhe këtë hap dhe le t'i çlirojmë zgjedhjet nga politika; le të pranojmë rezultatin; le të punojmë për të mirën e Shqipërisë. Faleminderit!